



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
SENATI AKADEMIK

Nr. 2612 / prot.
3

Elbasan, më 21 .10.2024

VENDIM

Nr. 9, datë 21.10.2024

**"PËR SHPALLJEN E PROCESIT TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE PËR
ANËTAR PËRFAQËSUES TË NJËSIVE KRYESORE NË KËSHILLIN E ETIKËS TË
UNIVERSITETIT TË ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Statutit të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", Senati Akademik

VENDOSI:

1. Të shpallë procesin e regjistrimit të kandidatëve për anëtar përfaqësues të njësive kryesore në Këshillin e Etikës të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".
2. Regjistrimi i kandidatëve fillon më datë 21.10.2024 dhe përfundon më datë 25.10.2024.
3. Kandidatët të dorëzojnë pranë sekretarisë së Senatit Akademik kërkesën për vetëkandidim.
4. Vendimi të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Prof.Dr. Elvira FETAHU

